



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:130203

Datë: 17.01.2023

Numri i dokumentit: 03865653

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.346/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykes Ali Kutllovci, me procesmbajtës Shukrije Selimi, në çështjen penale kundër të pandehurit: F.I për shkak të veprave penale: Kanosje nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.4046/2018 dt. 25.03.2019.Pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar në prezencën të pandehurit e ne mungesë të prokurorit të shtetit në PTH në Mitrovicë Sahit Tmava Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më 11.01.2023 në të njëjtën ditë ka shpallur publikisht aktgjykimin, ndërsa me dt.17.01.2023, ka përpiluar me shkrim këtë :

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

F.I , nga i ati e ëma, e vajzërisë , i lindur më dt....., në fshatin D..... Komuna e V..... tani me vendbanim ne V..... rruga ‘ ’ ‘ ’ me nr. personal Shqiptar Shtetas i republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme , i martuar baba i .. fëmive , punon si roje sigurimi në ndërmartjen ‘ ’.....i gjendjes së dobët ekonomike, i dënuar me parë dhe zhvillohet procedurë penale për vepër tjetër penale

I.

SHPALLET FAJTOR

SEPSE:

Me dt. 02.10.2018 rreth orës 7.15 min. në fshatin N..... Komuna e V..... saktësisht afër ‘ ’.....’ , I pandehuri seriozisht ka kanosur personin tjetër me fjalë se do ta privoj nga jeta

dhe atë të dëmtuarin , ashtu që pas një fjalosje rreth parkingut , ku i dëmtuari kishte parkuar automjetin e tij të markës ‘‘ Fiat Marea’’ , me targa pran objektit të ‘.....’ , ndërsa I pandehuri ishte në vendin e punës si roje sigurimi dhe fillimisht i thotë të dëmtuarit ‘‘ largoje automjetin nga aty , se nuk bënë me parku aty’’ , atëherë i dëmtuari ja kthen se ‘‘ nuk pengon automjeti asgjë aty , se kjo hapsirë nuk është e askujt’’ , atëherë i pandehuri nxjerr revolen nga brezi me dorën e djathtë, e repartit dhe e futë prape në brez duke i thënë të dëmtuarit ‘‘ tash unë të tregoi se a e largon veturën a jo’’ me që rast i dëmtuari ka shkaktuar frik dhe ankth për jetën e tij.

Me këtë ka kryer veprën penale; Kanosje nga neni 186 par 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së

II.

SHPALLET FAJTOR

SEPSE:

Në të njëjtën ditë , kohë dhe vend si nën pikën –I- të dispozitivit , i pandehuri ka mbajtur në pronësi , kontroll dhe në posedim armë në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla , ashtu që i pandehuri i është kanosur të dëmtuarit si nën pikën –I- të dispozitivit , e ku është informuar policia atëherë kur i pandehuri ka shkuar në stacionin policor te jep deklaratë lidhur me rastin dhe aty e ka dorëzuar armën – një revole ‘‘LUGER’’ të prodhimit Q..... , modeli .. të kalibri 9mm dhe 8 fishek te kalibri 99mm , të cilat janë konfiskuar nga ana e policisë.

- Me këtë ka kryer veprën penale; Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 41,43, 46, dhe nenit 185 par 2 lidhur me par 1 dhe 374 par.1 të KPRK-ës, e lidhur me nenet 282, 365 dhe 366 të KPP-së, të pandehurit, i;

SHQIPTON

Për veprën penale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ; DËNIM ME GJOBË në shumë prej 700€ (shtatëqind euro)

Për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi DËNIM ME GJOBË në shumë prej 700€ (shtatëqind euro),

Gjykata bazuar në dispozitën e nenit 80 par 2 pika 2.4 shqipton dënim UNIK në Shumen prej njëmijë e katërqind euro (1400) euro , të cilën dënim-gjobë obligohet ta paguaj brenda afatit prej (3) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se nuk e paguan këtë gjobë, atëherë e njëjta do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 43 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke ia llogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20€ (njëzet euro) gjobë.

I pandehuri obligohet të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, si dhe shumë prej 50 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumë prej 70 (shtatëdhjetë) euro, të gjitha obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

KONFISKIMI

Gjykata, në mbështetje të nenit 282 par.1 e 2 të KPP-së, si dhe neneve 374 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndaj të pandehurit lëshon këtë :

URDHËR - URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve si ne vijim:

Armës – një revole ‘LUGER’ të prodhimit Ç..... , modeli 85 të kalibrit 9mm dhe 8 fishek të kalibrit 99mm.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo armë – revole , dhe 8 fishek kal 9mm , duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, pasi që të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë krim tjetër.

Pala e dëmtuar lidhur me kërkesën pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil .

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.4046/2018 dt.25.03.2019, pran Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të rënda , ndaj të pandehurit: Kanosje nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Më 11.01.2023, Gjykata për këtë lëndë penale në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Seanca ishte mbajtur në prezencën e palëve: Prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë Sahit Tmava dhe të pandehurit F.I Seanca e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale ishte publike Palët nuk kanë paraqitur vërejtje në publicitetin e shqyrtimit fillestar.

I pandehuri, në seancën e shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga Gjykata lidhur me të drejtat e tij për në këtë fazë të procedurës penale, dhe pasi që u konfirmua se i njëjti i kupton këto të drejta, i pandehuri është deklaruar se e pranon në tërësi fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet: I. Kanosje nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Gjykata, ka marrë mendimin e palëve në lidhje me deklarinimin mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe nga prokurori i rastit , i cili i ka propozuar gjykatës, që këtë pranim të fajësisë të deklaruar nga i pandehuri ta pranoj gjykata si të bazuar, pasi që i njëjti ka mbështetje edhe në provat-shkresat e kësaj lënde penale.

Gjetjet e gjykatës

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri , e në mbështetje të nenit 248 par.4 të KPP-së, në këtë drejtim ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, gjen se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Raporti policor dt.02.10.2018, raporti i oficerit policor dt.02.10.2018, deklarata e të dëmtuarit , vërtetimi mbi konfiskimin e armës dt. 02.10.2018, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes dt. 02.10.2018 , lista e dëshmive si dhe foto dokumentacioni .Informacioni për evidencën e te kaluarës së të pandehurit. Të gjitha këto prova gjykata i vlerëson / por pa i administruar sepse i pandehuri e ka pranuar fajësinë ne shqyrtimin fillestar/ si prova relevante , të besueshme dhe me fuqi provuese për elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprave penale dhe të njëjtat janë konsistente dhe janë bindëse për gjykatën dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese e që në bazë të tyre dhe pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i njëjti ka kryer veprat penale: Kanosje nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Gjykata, gjen se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Gjykata i kishte tërhequr vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësin e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave të tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë.

Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë prej të pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimit ka vërtetuar se i pandehuri, para së gjithash është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprat penale për të cilat akuzohet.

Konfiskimi:

Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 dhe 2nënpar 2.1 të KPP-ës dhe neneve 374 par.3 të KPRK-ës, ndaj të pandehurit ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armëve: Armës – një revole ‘‘LUGER’’ të prodhimit Ç....., modeli 85 të kal 9mm dhe 8 fishek të kal 99mm të cilat janë sekuestruar nga policia.

Gjykata rikujton se i pandehuri s’kishte leje e as autorizim për posedimin e armës. Në anën tjetër sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike nga këto arsye gjykata ka vendosur t’i konfiskoj përherë dhe të njëjtat ka urdhëruar që të shkatërrohen. Gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e përhershëm të armëve sipas nenit 374 par.3 të KPRK-ës, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm, konfiskimi ishte propozuar në aktakuzë – dispozita e lartcekur e këtij Kodi, përcakton shprehimisht konfiskimin e detyrueshëm të tij.

Analiza e rrethanave për matjen e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata me rastin e matjes së dënimit, në përputhje me nenin 69 të KPRK-së për arritjen e qëllimit të dënimit nga neni 38 të KPRK-së e duke analizuar secilën rrethanë veç e veç nga neni

69 , për rregullat – parimet e përgjithshme për matjen e denimit / e duke patur kujdes për rrezikun e dyfishimit të llogaritjes së rrehanve sepse disa prej rrethanave të përcaktuara në këtë dispozit pasqyrojnë në një mënyrë elementet e figurës së veprës penale/ dhe atë; Shkallën e përgjegjësis penale – ashtu që lidhur me këtë rrethanë gjykata gjenë se i pandehuri është i përgjegjshëm dhe përgjegjës se i pandehuri ishte i aftë të kuptoj rëndësin e veprimeve të tija dhe i aftë ti kontrolloj veprimet e tija, i vetëdijshëm për veprimet e tija e duke e dëshiruar kryerjen e saj, duke qen i vetëdijshëm se veprimi i tij është i ndaluar me ligj me dashje direkte ka ndermarr veprimet për të mbajtur pa autorizim armën dhe në një moment për qëllim kanosje e përdor armën , kjo i atribuohet si rrethanë rënduese.

Motivi për kryerjen e veprës penale – nga rrethanat e rastit dhe provat e vlersuara nga Gjykata rezulton se motivi i mbajtjes së armës pa autorizim pothuaj ishte gjoja të ndihet më i sigurt e që mundë ti atribuohet si rrethanë rënduese. Ndërsa, intenziteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në rastin konkret vet fakti I kanosjes me armë pa marr parasyshtë arsyen I atribuohet si rethanë rënduese .

Lidhur me rrethanat në të cilat është kryer vepra penale - i pandehuri nënë arsyetimin për ta larguar të dëmtuarin për mos me parkuar automjetin afer rrethojave të vendit të punës ku ishte roje e sigurimit , kjo merret si rrethnë renduese.

Lidhur me sjelljen e mëparshme të kryersit , gjykata gjenë se i pandehuri ka qen i denuar edhe më parë.

Bazuar në rrethanat personale të kryersit e që lidhen me gjendjen persoanale dhe familjare , në veçanti fëmijën e të pandehurit të moshes së re ,vazhdon të punoj në ndermarrjen ‘Iber Lepenci’ , vlersohet si një rrethanë letsuese për të pandehurin. Pastaj, sjellja e tijë pas kryerjes së veprës penale – del se ka qenë shumë kooperativ me vet faktin se i njejt qyshë në fillim e pranoon fajsin.

Lidhur me pranimin e fajsis – gjykata gjenë se i pandehuri qysh në kontaktin e parë e pranon fajsin dhe vazhdimisht jep indikacione për pranim të fajsis , kjo tregon bindjen e tijë se i ka kuptuar veprimet e tija , ka kuptuar rëndësin e veprimeve të tija , sjelljen e tijë e rolin e tijë në këtë rast , e këtë e materjalizon në tërsi në rastin e parë pra në shqyrtim fillestar ku pa hezitur e pranon fajsin për veprat penale e që kjo është rrethanë ligjore për një denim më të butë sidomos kur i pandehuri këtë pranim e bene në kontaktin e parë me autoritetet e zbatimit te ligjit. Por , kjo rrethanë e shprehur ne këtë mënyrë domosdo duhet pranuar dhe të merret edhe nga gjykata si rrethanë letsuese. Ndërsa lidhur me rrethanat që kanë të bëjnë më personalitetin e kryesit – të gjitha rrethanat tregojnë se i pandehuri e ka kuptuar se veprimet e tija jane në kundërshtim me

ligjin dhe se është penduar dhe premtion vazhdimisht se nuk do të kryej më veprime të tilla por edhe rrethant e elaboruar amë lartë.

Në suaza të analizimit të këtyre rrethanave *një nga një* për individualizimin e denimit si kërkes ligjore për matjen e denimit dhe llojin e denimit , gjykata gjenë se *mbipeshojnë rrethanat rënduese* të përcaktuara në nenin 69 të KPRK-së.

Gjykata vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të pandehurit, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale, moshën e të pandehurit dhe rrethanat e tjera që i kemi cekur më lartë është adekuat dhe ne si gjykatë jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat e tjerë, që në të ardhmen të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Sa i përket dënimit me gjobë në këtë rast për të pandehurin gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marr parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 të KPP-ës.

Lidhur me kërkesën pasuroro juridike , gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 463 par 2 të KPP-së

Nga ajo që u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.346/2020 të datës 17.01.2023

Procesmbajtëse :

Shukrije Selimi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Ali Kutllovci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.